

08/ZDPNE/2023
Datë: 27 shtator 2023

Në mbështetje të nenit 15.1 (j), nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-05 1 për Aviacionin Civil, të ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura; neneve 76.3 dhe 115 të Rregullores (AAC) 05/2020 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Sigurinë e Aviacionit dhe ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 10/2015 dhe shfuqizimin e Rregullores (AAC) nr. 11/2009, Rregullores (AAC) nr. 03/2009 dhe Rregullores (AAC) nr. 6/2009; Rregullores (AAC) nr. 09/2020 për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/navigimit ajror dhe funksioneve tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre; Rregullore (AAC) nr. 01/2022 për ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 01/2020, Rregullores (AAC) nr. 17/2017 dhe Rregullores (AAC) nr. 09/2020 në lidhje me kërkesat për menaxhimin e trafikut ajror/shërbimet e navigimit ajror, projektimin e strukturave të hapësirës ajrore dhe cilësinë e të dhënave, sigurinë e pistës dhe shfuqizimin e Rregullores (AAC) nr. 08/2015; Rregullores nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror; dhe Udhëzimit Administrativ (AAC) nr. 02/2021 për zbatimin e specifikimeve të certifikimit, mjeteve të pranueshme të pajtueshmërisë dhe materialeve udhëzuese të AESA;

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr:

VENDIM

- Për zbatim në rendin juridik të Republikës së Kosovës të mjeteve të pranueshme të pajtueshmërisë dhe materialeve udhëzuese, të lëshuara nga AESA deri në datën të hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, në fushën e Shërbimeve të Navigimit Ajror, si në vijim:
 - Mjetet e pranueshme të pajtueshmërisë/materialet udhëzuese (AMC/GM) për Rregulloren (AAC) nr. 09/2020 e amendantar me Rregulloren (AAC) nr. 01/2022, që transponojnë Rregulloret e (KE) nr. 2017/373, përveç aneksit XIII, Pjesa-Pers, respektivisht (KE) nr. 2020/469;
 - Mjetet e pranueshme të pajtueshmërisë/materialet udhëzuese (AMC/GM) për rregulloren (AAC) nr. 19/2017 transponon Rregulloren e (KE) nr. 2015/340.
- Pika a) dhe b) të këtij Vendimi fillojnë të zbatohen nga data 01.10.2023
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arianit Islami
zv. Drejtor i Përgjithshëm



Iu dërgohet:

- Departamenti të Shërbimeve të Navigimit Ajror në (AAC);
- Agjencisë Shërbimeve të Navigimit Ajror (ASHNA);
- Arkivi t te AAC-së.